# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6923
E premte, 16 qershor 2023
Çmimi 0.40


## BE-ja: Marrja e masave ndaj Kosovës nuk u miratua lehtë FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KËSHILLI I SIGURISË I KOSOVËS KA MBAJTUR TË ENJTEN MBLEDHJE, NË TË CILËN ËSHTË DISKUTUAR PËR RRËMBIMIN E TRE ZYRTARËVE TË POLICISË SË KOSOVËS NGA FORCAT SERBE NË VERI FAQE 4-5

# KURTI DHE SVEÇLA I BËJNË THIRRJE FAKTORIT NDËRKOMBËTAR TA DËNOJË AGRESIONIN E SERBISË



Pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës, kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka kërkuar lirimin e menjëhershëm të tre zyrtarëve policorë, duke i bërë thirrje faktorit ndërkombëtar t'i dënojë veprimet e Serbisë. "Ajo çfarë është e çuditshme është heshtja dhe toleranca e faktorëve ndërkombëtarë ndaj veprimeve të Serbisë, e cila vazhdimisht kërkon pretekste për eskalim dhe destabilizim", ka thënë Kurti. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se institucionet e Kosovës nuk do të ndalen dhe nuk do të zmbrapsen në kërkim të drejtësisë, kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në vend

## SOT PEJA I PËRJETËSON NË PËRMENDORE HERONJTË AGIM QELA, BEKIM BERISHA, SKËNDER ÇEKU DHE XHEMAJL FETAHAJ FAQE 9



## AKTUALE



### GJYKIMI I LIDERËVE TË UÇK-së, KRYEGJYKATËSI PARALAJMËRON SANKSIONE NDAJ ZPS-SË PASI NUK E SOLLI DËSHMITARIN F. 7

### BORRELLI I VË KUSHTE KURTIT PËR RAUNDIN E RI TË DIALOGUT F. 3

### VENDIMI I QEVERISË PËR "KLAN KOSOVËN", MAVRAJ: JEMI ME JU KOLEGË GAZETARË! ASGJË E KEQE NUK GUXON T'U NDODHË! F. 2



## EKONOMI

### ODA GJERMANE: JEMI TË SHQETËSUAR QË KOMPANITË MUND TË HEQIN DORË NGA INVESTIMET NË KOSOVË F. 8

## SPORT



### GIRESSE DHE RRAHMANI: LUAJMË PËR FITORE NDAJ RUMANISË F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Vendimi i qeverisë për 'Klan Kosovën', Mavraj: Jemi me ju kolegë gazetarë! Asgjë e keqe nuk guxon t'u ndodhë!

**Prishtinë, 15 qershor** - Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar pasi Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka marrë vendim të mërkurën për pezullimin e certifikatës së biznesit të televizionit "Klan Kosova".
Mavraj ka shkruar në "Facebook" se gazetarët nuk kanë faj për dështimet kolosale në politikën e brendshme dhe të jashtme të qeverisë aktuale dhe as për shërbimet kolosale që po ia bën strategjisë ruso-serbe, si me telekomandë.
Mavraj ka thënë se në këtë situatë është me kolegët e "Klan Kosovës". "Jemi me ju kolegë gazetarë! Asgjë e keqe nuk guxon t'u ndodhë!", ka shkruar Mavraj.



**Postimi i plotë i Mavrajt:**

Me preku kjo paraqitje e kolegëve të KlanKosovës, por nuk i lëmë vetëm.
Këta nuk kanë faj që klubi i stanit e ka ndërkombëtarizuar deri në qiell një çështje aq te brendshme si ajo e pakicës në veri, aq rrezikshëm për të ardhmen e kombit, për tre vjet radhazi;
Gazetarët nuk kanë faj që stani me vetëdije të kthjellet po kalëron brenda strategjisë ruso-serbe për shkatërrimin e shtetit të Kosovës, ngushtësisht i lidhur dhe i pandashëm nga aleanca amerikane;
Gazetarët nuk kanë faj për dështimet kolosale në politikën e brendshme dhe të jashtme të kësaj udhëheqjeje dhe as për shërbimet kolosale që po ia bën strategjisë ruso-serbe, si me telekomandë.
Në vend se gazetarët ta mbyllin gojën, është koha e fundit që të interesuarit ta hapin mendjen, ose do të përfundojnë në namin e gjeneratave shërbëtorë ndaj projekteve rrënuese të qenësisë së Kosovës!




# Kelmendi: Mbyllja e gojës së medies ndodh vetëm në Rusi, Bjellorusi, Serbi dhe Kore të Veriut

**Prishtinë, 15 qershor** - Gazetari Adriatik Kelmendi ka reaguar ndaj vendimit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për pezullim të certifikatës së biznesit të "Klan Kosovës". Ai ka shkruar në "Facebook" se ky vendim është përpjekje për frikësim. "Nëse këtë ia bëjmë një medie si 'Klan Kosova', paramendojeni sa çka u bëjmë të tjerëve. Shqiptarët kanë derdhur edhe gjak për ta arritur lirinë. Breza gazetarësh kemi luftuar me çdo kusht edhe në kohën e Miloshevigit, edhe të luftës, edhe të UNMIK-ut, edhe të gjitha qeverive ta ruajmë lirinë e pavarësinë. Fjalën e lirë, mendimin e lirë", ka shkruar Kelmendi.
Ai ka thënë se mbyllja e gojës së medies ndodh vetëm në vende si Rusia e Bjellorusia, Serbia dhe Koreja e Veriut, jo në Kosovën tonë, jo në popullin të cilit askush asnjëherë nuk ka mundur t'ia mbysë idealin për të jetuar i lirë.
Për pezullimin e certifikatës së biznesit të "Klan Kosovës" ka reaguar edhe Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias - ECPMF.



# Osmani: Drafti i Ramës për asociacionin, tentim për t'i nxjerrë palët nga ngujimi

**Strugë, 15 qershor** - Maqedonia e Veriut po ndjek me vëmendjen zhvillimet në Kosovë, përfshirë rastin e rrëmbimit të tre policëve, të cilat, siç pohojnë autoritetet në Prishtinë, janë rrëmbyer nga forcat speciale serbe brenda territorit të Kosovës. Shkupi zyrtar u ka bërë thirrje palëve, në veçanti asaj të Kosovës, të bashkëpunojë ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare.
Ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, në kuadër të një konference ndërkombëtare në Strugë, "Prespa Forum", kushtuar zgjerimit të Bashkimit Evropian, ka thënë se bashkëpunimi me aleancën euroatlantike, BE-në dhe ShBA-në, është me rëndësi të madhe për kapërcimin e problemeve bazuar në përvojën maqedonase. "Unë vetëm mund t'i ftoj autoritetet e Kosovës që të jenë në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin euroatlantik për shkak se përvoja jonë na tregon se bashkëpunimi me ta, koordinimi me ta, besimi në ta, asnjëherë nuk na ka dështuar, nuk na ka tradhtuar. Këshilla më e mirë që mund t'ia japim, jo vetëm Kosovës, por të gjithëve në rajon - që t'i mbani ngushtë raportet me komunitetin euroatlantik për shkak se kjo është e ardhmja e vetme e rajonit", ka thënë Osmani.
Më tutje, ai ka folur edhe për draft-propozimin e kryeministrit shqiptar Edi Rama për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, duke theksuar se bëhet fjalë për një "nismë të re" për t'i lëvizur palët nga pozicionet e tyre.
Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ua ka propozuar një draft për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelarit gjerman



Olaf Scholz, veprim ky që është kritikuar në Prishtinë.
Osmani nuk e ka komentuar përmbajtjen e propozimit pasi, siç ka thënë, janë disa tekste që synojnë uljen e tensioneve dhe arritjen e një zgjidhjeje, megjithëse Prishtina është ajo që do të vendosë se cila është më e mira për Kosovën. "Pa e komentuar këtë tekst, pasi ka edhe tekste të tjera të cilat i kemi parë, nuk pretendoj se zoti Rama tenton të imponojë zgjidhje. Ai tenton të krijojë shteg, një dalje nga ky ngujim. Edhe në emër të shtetit (Maqedonisë së Veriut) dhe në emër të OSBE-së (si shtet kryesues i OSBE-së) përshëndes këtë nismë të kryeministrit të Shqipërisë që mendoj se është shumë qëllimmirë, pa u futur në tekstin konkret për shkak se është një prej teksteve nga të cilat mund të nxirret më e mira. Por, autoritetet e Kosovës janë ato që vendosin se cila është më e mira për ta", është shprehur Osmani.
Ai, gjithashtu, ka bërë me dije pjesëmarrjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në këtë Forum ditën e premte, duke thënë se deri të enjten nuk ka ndonjë konfirmim për anulimin apo mospjesëmarrjen e tij.
Ndërkohë, zhvillimet në Kosovë, në veçanti rastin me policët e Kosovës, e ka dënuar edhe kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, duke kërkuar nga autoritetet serbe lirimin e menjëhershëm të tyre, por edhe duke i dhënë mbështetje ruajtjes së integritetit dhe sovranitetit territorial të Kosovës. "Dënoj ashpër aktin e kidnapimit të policëve të Kosovës nga forcat speciale të Serbisë dhe pres lirimin e menjëhershëm të tyre. Pala serbe duhet t'i ndalojë provokimet menjëherë dhe të dyja palët të ulen urgjentisht në tavolinën e bisedimeve dhe me ndërmjetësimin e aleatëve tanë, bashkësisë euro-amerikane, t'i japin fund kontestit shumëvjeçar përmes njohjes së ndërsjellë. Integriteti dhe sovraniteti territorial i Kosovës janë të paprekshëm dhe të garantuar nga faktori ndërkombëtar", ka shkuar Ahmeti në "Facebook".
Reagime për rastin me policët nga Kosova ka pasur edhe nga partitë e tjera politike shqiptare, ndërkohë që zhvillimet në veri janë ndjekur me vëmendje të madhe nga të gjitha mediet në Maqedoninë e Veriut.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## BE-ja: Marrja e masave ndaj Kosovës nuk u miratua lehtë

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Bashkimi Evropian ka përsëritur të enjten se ndaj Kosovës nuk janë vendosur sanksione apo masa kufizuese për të cilat duhet të respektohen korniza dhe procedura e caktuar në BE, por vetëm masa dhe instrumente të përkohshme për të dëshmuar se BE-ja është serioze në përpjekjet e saj për t'i ulur tensionet. Këtë e ka thënë zëdhënësi i BE-së për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë, Peter Stano, të enjten në një konferencë për medie në selinë e Komisionit Evropian në Bruksel.

Stano ka përsëritur se këto masa janë të përkohshme dhe se do të hiqen nga rendi i ditës kur kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të marrë hapa që kërkohen nga ai për t'i ulur tensionet. Ai ka thënë se disa nga këto masa nuk kanë qenë të lehta për BE-në që t'i miratojë, por janë ndërmarrë pasi, sipas tij, "është parë se nuk ka hapa për shtensionim të situatës". "Pra, fjala është për instrumente që ne përdorim për të dëshmuar se BE-ja është serioze kur thotë se pret shtensionim të situatës dhe reagim kur një gjë e tillë nuk ndodh", ka thënë Stano.



# Borrelli i vë kushte Kurtit për raundin e ri të dialogut

EPOKA E RE Faton DËRMAKU




PRISHTINË, 15 QERSHOR - Përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se një raund i ri i dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mund të organizohet para se Kosova të marrë hapa për ta shtensionuar situatën.

Borrelli i është përgjigjur kështu letrës që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i dërgoi atij ditë më parë, duke ia paraqitur planin e tij prej pesë pikash që, sipas kryeministrit të Kosovës, do të ndihmojë në uljen e tensioneve në veri të vendit. "Siç e dini, unë jam i gatshëm të thërras një takim të nivelit të lartë me ju dhe presidentin [e Serbisë, Aleksandër] Vuçiq, me parakushtin që ju të jeni i gatshëm t'i ndërmerrni fillimisht hapat për shtensionim dhe të hapni rrugë për zgjedhjet e reja. Nuk mund të kemi përparim në normalizimin e raporteve përderisa ne merremi me menaxhimin e krizave. Të 27 shtetet e BE-së, por edhe ShBA-ja, kanë investuar shumë në procesin e normalizimit dhe ne duam të shohim që ky proces lëviz përpara. Prandaj, shtensionimi i situatës kërkohet të ndodhë menjëherë. Nëse jeni i gatshëm t'i ndërmerrni hapat e nevojshëm, një takim i ri mund të organizohet shpejt", ka thënë Borrelli në letrën që i dërgoi Kurtit.

Zyrtari evropian ka kërkuar që kryetarët e rinj shqiptarë në komunat në veri të mos punojnë nga zyrat në objektet komunale, tërheqjen e policisë nga afërsia e këtyre ndërtesave dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore. "Paralelisht, ne po i kërkojmë Serbisë ta mbështesë tërheqjen e elementeve radikale nga këto zona", ka shkruar Borrelli.

Kurti më 13 qershor njoftoi se i ka dërguar Borrellit planin për shtensionimin e situatës në veri. Plani i tij parasheh pesë pika që, sipas tij, ndihmojnë në ulje të tensioneve: përmbushjen e ndjekjes penale dhe gjykimin e kriminelëve që sulmuan Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe gazetarët; ndërprerjen e menjëhershme të sulmeve të grupeve të dhunshme kundër institucioneve legjitime në raport me të cilën do të mund të bëhej zvogëlimi i pranisë së policisë në objektet komunale; vlerësimet e përbashkëta të sigurisë në mes të Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it çdo pesëmbëdhjetë ditë për të garantuar një ambient të sigurt për të gjithë; koordinim ndërmjet qeverisë dhe të gjithë aktorëve për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të cilat duhet të organizohen në një atmosferë të lirë, demokratike dhe të papenguar liberale; rikthimin e menjëhershëm në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, teksa ky i fundit siguron një plan të sekuencimit të drejtë dhe të balancuar të zbatimit të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit të saj.

# Kryebashkiaku i Majamit shpall kandidaturën për president të ShBA-së

UASHINGTON, 15 QERSHOR - Kryebashkiaku i Majamit, Francis Suarez, ka njoftuar kandidaturën e tij për president të ShBA-së, duke iu bashkuar radhës së gjatë që kërkojnë nominimin republikan.

Suarez, 45 vjeç, ka paraqitur dokumente në Komisionin Federal të Zgjedhjeve, duke u bërë kandidati i parë hispanik në garën presidenciale të ShBA-së që do të mbahen në vitin 2024.

Suarez, djali i kryebashkiakut të parë të Majamit me origjinë kubaneze, do të përballet me ish-presidentin e ShBA-së, Donald Trump, ish-zëvendëspresidentin Mike Pence, guvernatorin e Floridës, Ron DeSantis, ish-guvernatoren e Karolinës së Jugut, Nikki Haley, senatorin Tim Scott, ish-guvernatorin e Arkansas, Asa Hutchinson, manjatin Vivek Ramaswamy, ish-guvernatorin e New Jersyt, Chris Christie dhe miliarderi - guvernatori i Dakotës së Veriut, Doug Burgum.

Ish-presidenti Trump, ndaj të cilit janë ngritur dy padi, favorizohet në shumicën e sondazheve kombëtare, i ndjekur nga DeSantis. DeSantis shihet si sfiduesi më serioz republikan i Trumpit.

Në frontin demokrat presidenti Joe Biden është duke rikandiduar edhe për një mandat në Shtëpinë e Bardhë, ndërsa është sfiduar nga autorja bestseller, Marianne Williamson dhe Robert F. Kennedy Jr., nipi i ish-presidentit amerikan John F. Kennedy.






KËSHILLI I SIGURISË I KOSOVËS KA MBAJTUR TË ENJTEN MBLEDHJE, NË TË CILËN ËSHTË DISKUTUAR PËR RRËMBIMIN E TRE ZYRTARËVE TË POLICISË SË KOSOVËS NGA FORCAT SERBE NË VERI

# Kurti dhe Sveçla i bëjnë thirrje faktorit ndërkombëtar ta dënojë agresionin e Serbisë

Pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës, kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka kërkuar lirimin e menjëhershëm të tre zyrtarëve policorë, duke i bërë thirrje faktorit ndërkombëtar t'i dënojë veprimet e Serbisë. "Ajo çfarë është e çuditshme është heshtja dhe toleranca e faktorëve ndërkombëtarë ndaj veprimeve të Serbisë, e cila vazhdimisht kërkon pretekste për eskalim dhe destabilizim", ka thënë Kurti. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se institucionet e Kosovës nuk do të ndalen dhe nuk do të zmbrapsen në kërkim të drejtësisë, kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në vend

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Këshilli i Sigurisë i Kosovës (KSK) ka mbajtur të enjten mbledhje, në të cilën ka diskutuar për rrëmbimin e tre zyrtarëve të Policisë së Kosovës në brendi të territorit të republikës sonë. Pas mbledhjes së KSK-së, kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka treguar se me anëtarët e Këshillit të Sigurisë kanë diskutuar për situatën e përgjithshme të sigurisë, me theks në katër komunat në veri të vendit dhe brezit kufitar me Serbinë.

Ai ka thënë se institucionet e sigurisë dhanë vlerësimet e tyre, dhënat më të fundit dhe propozuan rekomandime. "Rasti i djeshëm ishte agresion ndaj shtetit tonë demokratik, hakmarrje ndaj Policisë së Kosovës që po lufton krimin dhe intencë për përshkallëzim e destabilizim në kohën kur ne tashmë kemi propozuar planin 5-pikësh për depërshkallëzim, pra deeskalim dhe për normalizim. Për këto arsye institucionet tona të rendit dhe sigurisë e kanë rritur nivelin e gatishmërisë. Për arsye të sigurisë, si hap i menjëhershëm dhe i domosdoshëm, janë shtrënguar kontrollet kufitare me Serbinë, duke kufizuar qarkullimin dhe duke shtuar kontrollet e automjeteve që vijnë nga Serbia, sidomos ato transportuese", ka thënë Kurti, duke shtuar se cenimi i kufirit nga Serbia na detyron t'i rritim kontrollet kufitare që, varësisht nga analizat dhe vlerësimet e vazhdueshme të institucioneve të sigurisë, mund të përfshijnë edhe ndalesa të qarkullimit në rastet kur vlerësohet se mund të përbëjnë apo nuk mund të garantohet siguria. "Veprimet e radhës do të merren në bazë të rekomandimeve të institucioneve përkatëse. Synimi ynë është siguria e siguria fillon te kufijtë", ka deklaruar Kurti.

Kurti ka paraqitur një foto të hartës, përmes së cilës ka treguar vendin ku janë rrëmbyer tre policët. Sipas tij, ky vend ndodhet më shumë se një kilometër prej kufirit në thellësi të territorit të Kosovës. "Pra, rrëmbimi i tre policëve të Kosovës ka ndodhur në këtë vend, i cili është thellë në territorin e Kosovës dhe i cili është pra, 1 kilometër larg kufirit në njërën anë, që i bie të jetë pjesa veriperëndimore, pastaj 670 metra larg, që i bie pjesa veriore dhe në pjesën jugperëndimore 300 metra; 1 kilometër, 670 metra dhe 300 metra. Në të njëjtën kohë, këtu kemi edhe fotografitë e rrugës së prerë, në të cilën shihet qartazi se nuk kanë mundur këta të kalojnë tutje siç pretendon Serbia, që paskan shkruar në Serbi dhe atje qenkan arrestuar. Pra, nuk bëhet fjalë për arrestim në Serbi, por bëhet fjalë për kidnapim në Kosovë dhe kjo rruga e prerë këtu është bërë për t'i ndalur këto 16 shtigjet ilegale të kontrabandës, që janë bërë gjatë vitit të kaluar dhe nuk bëhet fjalë për kurrfarë kalimi të policisë përtej kufirit të Serbisë siç pretendohet, madje as përtej rrugës së prerë e cila ndodhet 1 kilometër, 670 metra dhe 300 metra", ka thënë Kurti. Ai ka paraqitur edhe një fotografi tjetër, e cila tregon që rruga ka qenë e prerë, duke hedhur poshtë pretendimet e rrejshme të Serbisë.

Kurti ka thënë se bëhet fjalë për dy formacione të armatosura të Serbisë që kanë hyrë në territorin e Kosovës dhe me të cilët do të duhej të merret KFOR-i, Njësia Speciale Anti-terroriste SAJ dhe Njësia Speciale Ushtarake "Kobra". Kryeministri ka kërkuar lirimin e menjëhershëm të tre policëve dhe i ka kërkuar nga faktori ndërkombëtar ta dënojë këtë akt agresioni të Serbisë. "Ne edhe një herë kërkojmë lirimin e menjëhershëm të tre zyrtarëve të rrëmbyer policorë dhe u bëjmë thirrje faktorëve ndërkombëtarë ta dënojnë këtë akt agresioni të Serbisë dhe të bëjnë trysni mbi Beogradin zyrtar. Serbia nuk ka →

# Hoti: Po krijohen situata që e rritin rëndësinë e Rezolutës 1244

**Prishtinë, 15 qershor** - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, duke folur për situatën e fundit në veri, ka thënë se po krijohen situata që e rritin rëndësinë e Rezolutës 1244 në menaxhim të sfidave të sigurisë në Kosovë. "Për shkak të: (1) mungesës së rezonit shtetëror në menaxhimin e interesave shtetërore të Kosovës, (2) ndjekjes së qëllimeve të ngushta elektorale në vendime të natyrës strategjike e të sigurisë nacionale, si dhe (3) pa koordinim me aleatët në këto vendime, po krijohen situata që e rritin rëndësinë e Rezolutës 1244 në menaxhim të sfidave të sigurisë në Kosovë", është shprehur Hoti, duke shtuar se një gjë e tillë përbën kthim prapa për Kosovën. "Kjo përbën kthim prapa. Në qeveritë paraprake, në pamundësi që Rezoluta 1244 të anulohet formalisht në Këshillin e Sigurisë të OKB-së, është punuar me aleatët në zbehjen totale të rëndësisë së saj. Kjo qasje ka përfshirë edhe raportimin më të rrallë në OKB dhe me përfaqësim gjithnjë e më të ulët nga ana e Kosovës. Shpresoj se këto situata të mos jenë të pakthyeshme në Qeverinë e ardhshme të Kosovës, e cila duhet ta kthejë menjëherë normalitetin në vend dhe bashkëpunimin e ngushtë dhe të domosdoshëm me aleatët", ka shkruar Hoti në "Facebook".



# Presidenti i Shqipërisë bën thirrje për lirimin e tre policëve të Kosovës



Prishtinë, 15 qershor - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka reaguar të enjten për arrestimin e tre policëve të Policisë së Kosovës për të cilët Prishtina zyrtare thotë se janë rrëmbyer nga forcat serbe. Begaj e cilëson ngjarjen akt të rëndë provokues, që synon destabilizim jo vetëm të Kosovës, por të gjithë rajonit. "E dënoj me forcë këtë akt dhe u bëj thirrje autoriteteve serbe për lirimin e efektivëve kosovarë. Gjithashtu, u bëj thirrje partnerëve ndërkombëtarë të ndërhyjnë dhe të shkurajojnë veprime të tjera të ngjashme", ka shkruar Begaj në "Facebook". Kreu i shtetit shqiptar i bëri thirrje Kosovës të mos bjerë pre e provokimeve, por të kontribuojë për uljen e tensioneve. "Koordinimi me ShBA-në dhe BE-në për rikthimin në tryezën e dialogut është tepër i rëndësishëm", tha presidenti i Shqipërisë.

# Tahiri: Vuçiqi i kidnapoi policët sepse gjeti hapësirën e dëmtimit të aleancës me Amerikën

Prishtinë, 15 qershor - Ish-kryenegociatorja në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka reaguar rreth rrëmbimit të tre zyrtarëve të Policisë së Kosovës. Tahiri në "Facebook" ka shkruar se Vuçiqi është një Millosheviq i vogël i cili guxoi t'i rrëmbejë zyrtarët policorë sepse gjeti hapësirën e dëmtimit të aleancës me Amerikën, të cilën e bëri Kurti. "Fuqia gjeopolitike dhe gjeostrategjike e Kosovës është te veriu për pasuritë që botërisht dihen, por janë dhe dy arsye që i japin peshë specifike në marrëdhënie ndërkombëtare. Prandaj mund ta mbrojmë këtë vlerë të shtetit tonë vetëm duke ruajtur Aleancën me Amerikën", ka shkruar Tahiri.



→

ndryshuar asnjëherë në qëllime, motive dhe apetite. Nuk është se po na befason me sjelljen e saj. Ajo çfarë është e çuditshme është heshtja dhe toleranca e faktorëve ndërkombëtarë ndaj veprimeve të Serbisë, e cila vazhdimisht kërkon pretekste për eskalim dhe destabilizim. E kur nuk ka, atëherë është e gatshme dhe sigurisht e aftë t'i krijojë ato. Rrëmbimi i tre policëve të Kosovës është dëshmia më e qartë dhe më e freskët për këtë", është shprehur Kurti.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se e ka vizituar lokacionin ku ka ndodhur ngjarja. "Bëhet fjalë për një rrugë ku më herët ka pasur kontrabandë dhe pikërisht ajo rrugë është bllokuar nga ana jonë. Pra, rruga është e ndarë në mes, me dy gropa të njëpasnjëshme dhe ka qenë e pamundur që policët të kalojnë në territorin e Serbisë, ashtu si propaganda e Beogradit thotë. Kjo është pastër një deformim i ngjarjeve në terren, për t'i ikur përgjegjësisë së tyre, realisht planit të tyre për kidnapim. Në këtë lokacion, në prapavijë në territor të Republikës së Kosovës, ka pasur edhe drunj që kanë bllokuar rrugën me qëllim të bllokimit eventual të njësive asistuese të Policisë së Kosovës. Është e qartë se ky akt kriminal është bërë në shenjë hakmarrje për arrestimin e kriminelit Llune. Ajo çfarë është duke ndodhur është sjellja e një Serbie kriminele, e cila me vite e dekada është duke vepruar njëjtë përmes akteve të tyre kriminale duke u munduar ta minojnë shtrirjen e sovranitetit tonë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë Sveçla.

Ai ka thënë se institucionet e Kosovës nuk do të ndalen dhe nuk do të zmbrapsen në kërkim të drejtësisë, kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në vend. "Ne jemi në të drejtën tonë dhe do të vazhdojmë të veprojmë sipas ligjit dhe principeve të demokracisë. Çdokush i cili shkel ligjin do të përballet me pasojat ligjore. Askush nuk është imun në këto shkelje. Asnjëri nga këta kriminel nuk është më i fuqishëm se shteti, nuk është më i fuqishëm se institucionet e Republikës së Kosovës, prandaj secili prej tyre do të sillet para drejtësisë", ka thënë ministri Sveçla.

## Përurohen renovimet në QKMF-në "Dr. Shpëtim Robaj'"



**Malishevë, 15 qershor** - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, i shoqëruar nga nënkryetari Vesel Krasniqi, kryesuesi i Kuvendit, Argjend Thaçi, drejtori Afrim Krasniqi, si dhe drejtorët Morina e Rexha, të enjten kanë përuruar renovimet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë "Dr. Shpëtim Robaj".
Kryetari Kastrati ka përgëzuar stafin mjekësor për shërbimet që po ua ofron me profesionalizëm qytetarëve. "Sot kemi një objekt të izoluar mirë, me një hapësirë tejet të përshtatshme dhe që ofron kushte me standarde të larta, me garazhe për vetura, oborr me parking të mjaftueshëm dhe të rregulluar për qarkullim pa pengesa dhe që lehtëson e ofron shërbimeve më të shpejta dhe cilësore në të gjitha repartet", ka thënë Kastrati.
Ky projekt është një prej projekteve të shumta që është realizuar dhe financuar nga buxheti i komunës së Malishevës.

# 24-vjetori i çlirimit të Gjilanit, Hyseni bën homazhe te Varrezat e Dëshmorëve



**Gjilan, 15 qershor** - Gjilani ka shënuar të enjten 24-vjetorin e Çlirimit, përvjetor ky që po shënohet me një varg aktivitetesh, të cilat po mbahen nën përkujdesjen e kryetarit të komunës, Alban Hyseni. Fillimisht janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, me ç'rast kryetari Alban Hyseni ka thënë se sot nderojnë dëshmorët dhe të rënët për liri për t'i përkujtuar përgjithmonë themelet mbi të cilat është ngritur ky shtet. "Sot nderojmë dëshmorët dhe të rënët për liri për t'i përkujtuar përgjithmonë themelet mbi të cilat është ngritur ky shtet dhe bazën e vlerave të cilat duhet t'i respektojë shoqëria jonë", ka thënë Hyseni.
Ai ka theksuar se sakrifica e madhe që është bërë për shtetin, duhet të jetë gjithmonë në kujtesën tonë gjatë punës së përditshme.
Në emër të komunës së Gjilanit, kryetari Hyseni ua ka uruar të gjithë qytetarëve Ditën e Çlirimit, me shpresën dhe me besimin që këto kujtime që i bëjnë në këta përvjetorë, të jenë gjithmonë në punën e përditshme si kujtesë e shoqërisë për sakrificën e madhe që është bërë për ta ndërtuar shtetin tonë.
Kurse ish-komandanti i Zonës Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, ka thënë se para 24 vjetësh Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me aleatin e saj më të fuqishëm, ushtrinë amerikane, hynë në Gjilan dhe e bënë qytetin e lirë, ditë kjo që erdhi pas një përpjekjeje dhe sakrifice shekullore të brezave.

# Lladrovci merr pjesë në përurimin e objektit afarist 'IP Kos' në Drenas

**Drenas, 15 qershor** - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka marrë pjesë në përurimin e objektit afarist 'IP Kos' në Drenas, në pronën e dhënë e dhënë me qira përmes shpalljes publike. Lladrovci ka vlerësuar se përmes këtij objekti afarist do të përfitojë jo vetëm komuna përmes qirasë, por edhe qytetarët e Drenasit, pasi në këtë qendër do të punësohen mbi 120 veta. Ai ka thënë se zotimi i investitorit 'IP Kos' ka tejkaluar në të gjitha drejtimet, në veçanti në numrin e të punësuarve.
Objekti afarist 'IP Kos' ka bërë investime mbi 5 milionë euro dhe në të kanë gjetur punë mbi 120 veta nga Drenasi.
'IP Kos' ka zbatuar marrëveshjen, duke tejkaluar zotimin për investime dhe tejkalimin e zotimit për punësim. Ky vend do të jetë tërheqës për qytetin e Drenasit, me derivate të naftës, ushqim, veshmbathje, shërbime cilësore me brendet Heb's, Aztech, LC Waikiki, Missini Sweets, ndërsa së shpejti në këtë objekt afarist do të jetë edhe marketi me gjëra ushqimore dhe autolarje vetëshërbyese.
Investitori për këtë pronë të marrë përmes shpalljes publike të dhënë nga komuna e Drenasit paguan qira vjetore në vlerën prej 31 820.00 eurosh.
Objekti afarist shtrihet në mbi 7 000 mijë metra katrorë.




# Hamza pret në takim ambasadorin e OSBE-së, diskutojnë për projektet e përbashkëta



**Mitrovicë, 15 qershor** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Michael Davenport, me të cilin ka biseduar për çështjet politike në vend dhe për projektet e përbashkëta.
Gjithashtu, kanë diskutuar për mbështetjen profesionale të OSBE-së ndaj komunës së Mitrovicës për finalizimin e Planit të Integritetit për vitet 2023-2026 dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale në komunën e Mitrovicës së Jugut.
Në fund palët u pajtuan për bashkëpunim korrekt edhe në projektet të tjera gjithëpërfshirëse për qytetarët e Mitrovicës.

## Ndërtohet shteg i veçantë i rrugës për hyrje në "Abi Çarshia"

Prizren, 15 qershor - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se është duke u ndërtuar shtegu i veçantë i rrugës për hyrje në "Abi Çarshia", në mënyrë që komunikacioni ta ketë hapësirën e vet për të qarkulluar lirshëm në rrugën "Ekrem Rexha", që është mjaft e frekuentuar, sidomos gjatë fundjavave, kur numri i vizitorëve është shumë i madh. Sipas komunës, ky projekt do ta shkarkojë trafikun e dendur në këtë pjesë të rëndësishme të qytetit, që shërben edhe si transit për dalje të shpejtë në drejtim të Shqipërisë.



# Gjykimi i liderëve të UÇK-së, kryegjykatësi paralajmëron sanksione ndaj ZPS-së pasi nuk e solli dëshmitarin

HAGË, 15 QERSHOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka bërë shkelje të urdhrit të trupit gjykues sa i përket zhvillimit të procedurës, ka bërë me dije kryetari i trupit gjykues në rastin kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, pasi prokuroria nuk e ka sjellë dëshmitarin e radhës në seancën e sotme.
Kryegjykatësi Charles Smith ka paralajmëruar ZPS-në se një shkelje e dytë do të shqyrtohet për marrje sanksionesh.
Në Gjykatën Speciale në Hagë ka përfunduar dëshmia e dëshmitarit të nëntë të ZPS-së, pas së cilës parashihej të dëgjohej dëshmitari i radhës. Por, seanca është mbyllur në mungesë të pranisë së dëshmitarit të dhjetë, ndërsa trupi gjykues ka bërë me dije se me këtë ZPS ka bërë shkelje të urdhrit të turpit gjykues sa i përket procedurës. "Në këtë moment të gjykimit vetëm një organizatë është përgjegjëse për t'i thirrur dëshmitarët dhe për t'u kujdesur për pjesëmarrjen e tyre dhe kjo është ZPS-ja. Të gjithë këta njerëz dhe katër të akuzuarit të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në paraburgim janë në pritje të dëshmitarit të radhës, në mënyrë që kohën ta përdorin në mënyrë të përgjegjshme. Ky trup gjykues e ka marrë shumë seriozisht përgjegjësinë e vet për t'i mbrojtur të drejtat e të akuzuarve edhe për një gjykim të shpejtë dhe të drejtë", ka thënë kryegjykatësi Smith.
Më tutje, Smith ia ka bërë me dije ZPS-së se për një shkelje të dytë do të shqyrtohen edhe sanksionet. "ZPS-ja ka bërë një shkelje të drejtpërdrejtë të urdhrit të trupit gjykues sa i takon zhvillimit të procedurës. Ky është një paralajmërim i parë për ZPS-në. Një shkelje e dytë do të shqyrtohet pastaj për marrje sanksionesh. Ky është fundi i kësaj deklarate. Do të shihemi ditën e hënë", ka thënë Smith.
Pas kësaj deklarate, prokurori James Pace ka dashur të flasë, por nuk është lejuar nga kryegjykatësi Smith, i cili ka theksuar se parashtrimi mund të bëhet vetëm me shkrim.
Ndërsa urdhri për zhvillimin e procesit thotë se është përgjegjësi e palëve që të sigurojnë që në përfundim të dëshmisë së një dëshmitari, të ketë dëshmitar gati në rend për ta filluar dëshminë. E nëse një prej dëshmitarëve të propozuar nuk është në gjendje të dëshmojë sipas kalendarit apo nëse nuk ka kundërpyetje, ose nëse kundërpyetjet zgjasin më pak nga se pritej, pala thirrëse duhet të sigurojë që të ketë një dëshmitar alternativ të gatshëm për ta thirrur në mënyrë që të mos ketë vonesë në procedurë. Në këtë çështje gjyqësore deri tani kanë përfunduar dëshminë e tyre nëntë dëshmitarë të ZPS-së, të gjithë të mbrojtur, identiteti i të cilëve nuk është bërë me dije për publikun. Seancat janë zhvilluar kryesisht të mbyllura për publikun, apo dëshmitë janë shfaqur me përmbajtje të redaktuar. Liderët e UÇK-së, të cilët po akuzohen për krime të pretenduara të luftës, ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Për të gjitha akuzat ata janë deklaruar të pafajshëm.



# Lirohen katër qytetarët e Kosovës të arrestuar në Merdar

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Katër qytetarët e Kosovës të arrestuar më 13 qershor nga autoritetet serbe në Merdar janë liruar, ka njoftuar për "Radion Evropa e Lirë" Prokuroria e Kurshumlisë. Sipas Prokurorisë, bëhet fjalë për katër shtetas kosovarë të cilët janë mbajtur në burg nga 13 qershori, teksa thanë se ata nuk janë përgjegjës për policët e Kosovës.
Labinot Maliqi, vëllai i njërit nga të arrestuarit, konfirmoi për REL-in se vëllai i tij, dhëndri dhe dy të tjerë, janë liruar. "Unë jam tashmë me vëllanë, dhëndrin dhe dy qytetarët e tjerë. Nga Drejtoria e Policisë në Prokuple i kanë sjellë në Kurshumli dhe këtu i liruan. Nuk kam pasur kohë të bisedoj shumë, pasi sa u liruan-,por arsyeja e arrestimit ka qenë se para dy vjetësh e kanë goditur një kontejner të mbeturinave", tha ai. Sipas tij, të katërtit janë akuzuar për të njëjtën çështje.
Më 14 qershor Prokuroria Themelore Publike e Kurshumlisë - qytet në pjesën qendrore të Serbisë - konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se më 13 qershor Drejtoria e Policisë në Prokuple, Stacioni Policor në Kurshumli, ka caktuar masën e ndalimit deri në 48 orë ndaj personave K. M, H. F, M. E, dhe M. D., të gjithë nga Podujeva.
Bilana Millosavleviq, ushtruese e funksionit të prokurores publike në Kurshumli, kishte thënë se "ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer veprën penale: shkatërrim dhe dëmtim i pasurisë së njerëzve të tjerë në dëm të Republikës së Serbisë", pa ofruar më shumë detaje.
Qeveria e Kosovës të enjten bëri me dije se janë shtrënguar kontrollet kufitare me Serbinë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi se "synimi ynë është siguria, e siguria fillon te kufijtë".



# Ministrja Hajdari sërish flet për pezullimin e certifikatës së biznesit për "Klan Kosovën"



**PRISHTINË, 15 QERSHOR** - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka komentuar sot pezullimin e certifikatës për televizionin "Klan Kosova". Hajdari ka thënë se këtë rast e kanë proceduar në organet e hetimit dhe se ka ndodhur për shkak të dokumentacioneve me adresë të rreme. "Detyra e çdo zyrtari publik është ta mbrojë Republikën e Kosovës, duke filluar nga emri zyrtar i saj. Dhe duhet ta keni parasysh se për këtë nuk ka kompromis. Më vjen keq që ka ndodhur në biznesin që ushtron veprimtarinë e informimit publik, pra kjo e bën edhe më të rëndë. Por, siç e dini, ARBK trajton vetëm rastin e kompanisë si biznes, çështjet e medies trajtohen nga Komisioni i Pavarur i Medieve dhe as MINT as qeveria nuk hap media e as nuk mbyll media", ka thënë Hajdari.

"Dhe, për më shumë, arsyen pse është pezulluar certifikata e biznesit është, të jemi të qartë edhe një herë, se dokumentacioni me adresë të rreme, aq më keq me emërtim Gjakovë-Serbi dhe me emërtim Pejë-Serbi, është veprim shumë i rëndë përpara ligjit, përpara Kushtetutës dhe aq më shumë e, mbi të gjitha, është shumë e rëndë përpara vendit tonë. Është shumë e papërgjegjshme kjo situatë", ka potencuar ministrja.

Ajo ka shtuar se këtë rast e kanë proceduar në organet e hetimit, sepse mashtrimi është i madh. "Këtë rast e kemi proceduar në organet e hetimit, sepse mashtrimi është tepër i madh. Unë ftoj të gjithë të interesuarit ta respektojnë republikën tonë, emërtimet e republikës sonë dhe vazhdojmë tutje së bashku", ka shtuar Hajdari.

MINT ka bërë me dije se ka iniciuar kallëzim penal ndaj Shoqërisë Tregtare "Klan Kosova" Sh.P.K. Po ashtu, ka shtuar se ka marrë vendim ta pezullojë certifikatën e biznesit të "Klan Kosovës" deri në një vendim tjetër.

# Oda Gjermane: Jemi të shqetësuar që kompanitë mund të heqin dorë nga investimet në Kosovë



**PRISHTINË, 15 QERSHOR** - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (KDWV-OEGJK) ka shprehur shqetësimin lidhur me zhvillimet në veri të Kosovës, si dhe zhvillimet e fundit politike në vend.

Oda ka thënë se anëtarët e saj janë të shqetësuar që kompanitë gjermane mund të heqin dorë nga investimet në Kosovë, ose t'i ndërpresin aktivitetet ekzistuese. "Si përfaqësuese e 198 kompanive anëtare, përfshirë kompani gjermane dhe kosovare, investitorë potencialë dhe kompani anëtare, që punojnë ngushtë me kompani gjermane, OEGJK çdo ditë dëgjon shqetësimet në rritje nga ankesat e pranuara. Lajmet për paqëndrueshmëri politike dëmtojnë besimin e klientëve dhe investitorëve gjermanë në mënyrë të konsiderueshme. Kjo ndikon negativisht në marrëdhëniet ekonomike gjermano-kosovare dhe i shkakton dëm Kosovës si lokacion për investime dhe biznes", thuhet në komunikatën për media.

Oda Gjermane ka deklaruar se lehtësimi i tensioneve dhe nxitja e zhvillimit të një mjedisi të qëndrueshëm janë faktorë të rëndësishëm për krijimin e një klime të mirë të të bërit biznes. "U bëjmë thirrje vendimmarrësve politikë në Kosovë që të ndërmarrin hapa për rivendosjen e një mjedisi të qëndrueshëm politik", thuhet ndër të tjera.

## Ekonomia e Kinës ngadalësohet dukshëm gjatë muajit maj

**PEKIN, 15 QERSHOR** - Rimëkëmbja ekonomike kineze në fillim të këtij viti ka humbur vrullin në tremujorin e dytë, duke e shtyrë Bankën Qendrore të Kinës të ulë disa norma bazë të interesit. Prodhimi industrial u rrit 3.5 për qind në maj nga një vit më parë, më i ulët se parashikimi prej 5.6-përqindësh.

Shitjet me pakicë - një matës kryesor i besimit të konsumatorit - u rritën 12.7 për qind, duke munguar parashikimet e rritjes prej 13.6-përqindësh.

Të dhënat që variojnë nga anketat e fabrikave dhe tregtia deri te rritja e kredive dhe shitjet e shtëpive kanë treguar shenja dobësie për Pekinin. Prodhimi ditor i qymyrit ra nga muaji prill. Shifrat, gjithashtu, përforcojnë rastin për më shumë stimuj, pasi Kina përballet me rreziqe deflacioni, rritje të borxheve të qeverisë vendore, papunësi rekord të të rinjve dhe dobësim të kërkesës globale. "Kërkesa e brendshme e pamjaftueshme dhe kërkesa e jashtme e ngadaltë mund ta ndërpresin vrullin në muajt në vazhdim", tha Bruce Pang, kryeekonomist në Jones Lang LaSalle.

Bankat më të mëdha të vendit kohën e fundit kanë ulur normat e depozitave për ta lehtësuar presionin mbi marzhet e fitimit dhe për t'i inkurajuar kursimtarët të shpenzojnë më shumë.



# Sot Peja i përjetëson në përmendore heronjtë Agim Qela, Bekim Berisha, Skënder Çeku dhe Xhemajl Fetahaj

"Epoka e re"



PEJË, 15 QERSHOR - Siç bëhet me dije në një njoftim të komunës së Pejës, sot, më 16 qershor, për nder të Ditës së Çlirimit, nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, do të bëhet inaugurimi i përmendoreve të katër prej komandantëve më emblematikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të rënë për liri: Agim Qelaj, Bekim Berisha - "Abeja", Skënder Çeku dhe Xhemajl Fetahaj.
Ceremonia e inaugurimit fillon në orën 12:00 në Parkun "Karagaç", një nga parqet më të mëdha dhe më të bukura të qytetit të Pejës.
Përmendoret e tyre janë punuar nga skulptori Gëzim Muriqi.

**Agim Qelaj** lindi më 6 dhjetor 1961 në Pejë. Pas rënies heroike të Jasharëve në Prekaz më 5 mars 1998, kthehet nga Gjermania dhe u bashkëngjitet strukturave organizative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm ngarkohet eprorinstruktor për përgatitjen e njësive speciale për intervenime të shpejta pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe vepron në Likoc, në Açarevë, në Negroc dhe në Kleçkë.
Agim Qelaj, komandant "Coli", bie heroikisht më 19 korrik 1998 në betejën e Rahovecit, e njohur si një nga betejat më të mëdha të UÇK-së. Në shenjë hakmarrjeje për humbjet në betejë, ushtria dhe policia serbe vranë shumë civilë shqiptarë.
Më 14 dhjetor 2016 presidentja Atifete Jahjaga e ka dekoruar me Urdhrin "Hero i Kosovës". Ky urdhër u jepet personave që kanë bërë vepra sakrifice dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

**Bekim Berisha** lindi më 15 qershor 1966 në fshatin Graboc, komuna e Pejës. Ishte pjesëmarrës në luftërat në Kroaci dhe në Bosnjë kundër forcave serbe. Për cilësitë e larta si dhe guximin e treguar, gradohet nga shteti kroat me gradën e gjeneralit. Në fillim të marsit të vitit 1998, Bekim Berisha, i njohur me nofkën e luftës "Abeja", së bashku me një grup shokësh mërgimtarë, hynë në Kosovë dhe sistemohet në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, fillimisht në Açarevë të Drenicës.
Më 22 prill 1998 Bekim Berisha e ngrit flamurin shqiptar dhe hap Akademinë Ushtarake. Bie heroikisht në mbrojtje të Junikut më 10 gusht 1998 së bashku me luftëtarët trima Bedri Shala, Elton Zherka, Përmet Vula dhe Bashkim Leku.
Për meritat dhe heroizmin e treguar në luftën për çlirimin e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) e ka graduar pas rënies me gradën gjeneralmajor.
Më 10 gusht 2010 presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, e dekoroi me Urdhrin "Hero i Kosovës" luftëtarin dhe udhëheqësin e shquar ushtarak të Kosovës, Bekim Berisha - "Abeja".

**Skënder Çeku** lindi më 1 janar të vitit 1955 në fshatin Qyshk afër Pejës. Duke qenë bashkëveprimtar politik i dy prej themeluesve të UÇK-së dhe anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, Xhavit Haliti dhe Adem Grabovci, Skënder Çeku angazhohet që në fillet e saj për furnizimin me armatim të pjesëtarëve dhe njësive të saj të para.
Që nga viti 1997 shtëpia e tij në Durrës u shndërrua në një bazë të fuqishme armatimi të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë kësaj kohe kontakton dhe njeh shumë shokë të veprimtarisë, të cilët më vonë bien dëshmorë, siç ishin Ilir Konushevci, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci e të tjerë. Njëkohësisht shënon një bashkëpunim të veçantë me strukturat ushtarake të Shqipërisë, përfshirë edhe komandantin e Divizionit të Kukësit, gjeneralin Kudusi Lama.
Pas shpërthimit të luftës frontale në disa zona të Kosovës, Skënderi Çeku u autorizua nga Shtabi i Përgjithshëm të angazhohet, përpos në sferën e logjistikës së armatimit, edhe në detyrën për ngritjen e bazave të UÇK-së në zonat përgjatë kufirit të Kosovës me Shqipërinë.
Në fillim të verës së vitit 1998 Skënderi hyri në Kosovë së bashku me dhjetëra bashkëluftëtarë. Në këtë rast ai solli një sasi të konsiderueshme të armatimit të ngarkuar në një karvan kuajsh. Ai plagoset rëndë gjatë sulmeve të forcave serbe të ndërmarra kundër pozicioneve të UÇK-së në Loxhë më 15 korrik 1998. Me gjithë përpjekjet për t'ia shpëtuar jetën, më 17 korrik të vitit 1998 Skënder Çeku hyri në përjetësi, duke ia shtuar lavdinë Kosovës dhe ushtrisë së saj çlirimtare.
Për merita të dëshmuara ushtarake, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e ka graduar, pas rënies, me gradën gjeneralmajor. Ndërsa presidentja Atifete Jahjaga më 14 dhjetor 2016 i ka dhënë Urdhrin "Hero i Kosovës".

**Xhemajl Fetahaj** lindi më 27 maj 1964 në fshatin Raushiq, komuna e Pejës. Ishte burgosur në vitin 1984 dhe dënuar për veprimtari politike atdhetare me gjashtë vjet burgim. Pas daljes nga burgu, Xhemajlin e ndeshim në organizimin dhe daljen në ballë të demonstratave popullore të vitit 1990 që po mbaheshin në Pejë dhe në qytete të tjera.
Kthesën vendimtare veprimtaria politike e Xhemajl Fetahajt e shënon me fillimin e Aksionit të Pajtimit të Gjaqeve në vitin 1990 në Kosovë. Me përkushtim të veçantë ai dha kontribut të jashtëzakonshëm, veçanërisht në shtrirjen e dorës së pajtimit në mes të Buçollëve. Krahas kësaj, do të ngarkohet me detyra shtesë të natyrës ushtarake; sigurimin dhe strehimin e armatimit si dhe rekrutimin e pjesëtarëve të parë të grupeve të armatosura, me qëllimin final - përgatitjen për luftën çlirimtare të Kosovës.
Për të mos rrezikuar veprimtarinë dhe organizimin që ishte arritur në atë kohë, meqë UDB-a e kishte vënë në shënjestër të goditjes, Xhemajli në mënyrë të koordinuar nxirret jashtë Kosovës për t'u vendosur në Gjermani.
Xhemajl Fetahaj nuk mundi të qëndrojë kohë të gjatë fizikisht larg frontit të luftës çlirimtare në të cilin ishte hedhur Kosova dhe i gjithë kombi ynë.
Pasi që i bashkëngjitet këtij fronti në Koshare, merr detyrën e komandantit të forcave komando "DELTA". Xhemajl Fetahaj bie heroikisht në altarin e lirisë më 31 maj 1999 në pozicionet luftarake të C/2-shit, pas një serie ballafaqimesh luftarake të pandalshme në mes të UÇK-së dhe forcave armike serbe. Më 14 dhjetor 2016 nga presidentja Atifete Jahjaga i është dhënë Urdhri "Hero i Kosovës".







# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Lëndohet Elbasan Rashani, largohet nga grumbullimi



PRISHTINË, 15 QERSHOR - Mesfushori sulmues i Përfaqësueses së Kosovës, Elbasan Rashani, ka pësuar një lëndim për shkak të të cilit nuk do të jetë në dispozicion të përzgjedhësit Alain Giresse për dy ndeshjet kualifikuese kundër Rumanisë dhe Bjellorusisë për "Euro 2024". Pas lëndimit Rashani iu ka nënshtruar ekzaminimeve të hollësishme mjekësore nga stafi mjekësor i Përfaqësueses. "Pasi u vlerësua ndjeshmëria e lëndimit, u vendos që lojtari të lirohet nga grumbullimi dhe t'i vazhdojë procedurat e rikuperimit. Stafi i Përfaqësueses i uron Elbasanit rikthim sa më shpejt në fushën e gjelbër dhe shpreson që ai do të jetë i gatshëm e në formë për ndeshjet e shtatorit", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK).

# Giresse dhe Rrahmani: Luajmë për fitore ndaj Rumanisë

**Përzgjedhësi i Kosovës, Alain Giresse dhe kapiteni Amir Rrahmani kanë paralajmëruar se sonte fitorja do t'i takon "dardanëve", pasi është e vetmja rrugë për të mbajtur gjallë shpresat për kualifikim në Kampionatin Evropian. Të mërkurën fitore ka paralajmëruar edhe sulmuesi kryesor i Kosovës, Vedat Muriqi**



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Fitorja është opsion i vetëm për Përfaqësuesen e Kosovës në futboll në ndeshjen që e zhvillon sonte (e premte), kundër Rumanisë në kuadër të kualifikuese "Euro 2024". "Dardanët" në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45 përballen me rumunët që konsiderohen si konkurrentë për pozitën e dytë në grup. Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani që ka pasur një sezon të jashtëzakonshëm në Serie A me Napolin duke e fituar titullin e kampionit, ka thënë se "dardanët" e kanë detyrë të shënojnë fitore ndaj Rumanisë. "Kjo është ndeshja më e rëndësishme në këtë cikël kualifikues, pasi kemi përball konkurrentin kryesor për vendin e dytë. Rumania ka 6 pikë me plot meritë dhe shpresoj që ne të luajmë lojën tonë, të fitojmë dhe t'i afrohemi me pikë. Kjo ndeshje e vendos shumë fatin e këtij grupi dhe pres përkrahje nga tifozët për ta mposhtur Rumaninë, në mënyrë që të mbajmë gjallë shpresat për kualifikim. Synimi është ta fitojmë këtë ndeshje dhe do të japim gjithçka nga vetja për fitore", ka thënë Rrahmani, i cili e pranon se dështimi në këtë ndeshje do të thotë që Kosova mund ta harrojë ëndrrën për kualifikim në Evropian. Në konferencën për medie i pranishëm më kapitenin Rrahmani ishte edhe përzgjedhësi Alain Giresse. Strategu francez e pranon se të gjithë në kampion e "dardanëve" janë të motivuar për fitore. "Besoj se ata do të futen në fushë me motivim të madh për fitore. Kemi mungesa të rëndësishme, ngase Rashani është larguar nga grumbullimi për shkak të lëndimit, derisa Zhegrova nuk është stërvitur disa ditë dhe është duke u rikuperuar. Po shpresojmë që ai të jetë gati", ka thënë Giresse, i cili me këtë rast konfirmoi se rumunët kanë individë të shquar, por Kosova do të jap maksimumin për të rrëmbyer pikët e plota. Sulmuesi shtatlartë Vedat Muriqi të mërkurën ka thënë se në "Fadil Vokrri" s'ka opsion tjetër përveç tri pikëve në përballje me rumunët. "Kryesorja është se jemi optimistë në radhë të parë, por edhe jemi lojtarë që punojmë shumë, prandaj shpresoj në trepikësh në 'Fadil Vokrri' para tifozëve tanë. Këto padyshim janë dy ndeshje kruciale. Fillimisht kemi përballë Rumaninë, e cila ka katër pikë më shumë se ne dhe nuk mund të parashikoj situatë tjetër përveç tri pikëve. Çdo rezultat tjetër mund të na shkatërrojë dhe të na shkaktojë dhimbje, po ashtu edhe një destabilitet siç e kemi pasur në kualifikimet e kaluara. Prandaj, është i domosdoshëm trepikëshi në radhë të parë me Rumaninë, pastaj me Bjellorusinë në Budapest është histori tjetër", ka deklaruar Muriqi. Kosova në dy ndeshjet e zhvilluara në këto kualifikuese ka grumbulluar gjashtë pikë.

# FC Prishtina: Ende nuk ka vendim për licencim




PRISHTINË, 15 QERSHOR - Raportimet e medieve se Prishtina edhe zyrtarisht nuk është licencuar për pjesëmarrje në garat evropiane i ka mohuar klubi kryeqytetas. Përmes një reagimi në faqen zyrtare, FC Prishtina ka bërë me dije se ende as nuk ka nisur procesi gjyqësor për këtë çështje, derisa ka shtuar se ky proces është duke u monitoruar edhe nga UEFA. "Duam t'ju njoftojmë se ky lajm nuk është i vërtetë. KAS-i ende nuk ka caktuar as gjyqtarët e procesit, pra nuk ka filluar ende implementimi i gjyqit dhe këtë gënjeshtër nuk mund të kuptojmë ndryshe vetëm se trysni ndaj gjyqit. Po ashtu, ju bëjmë me dije se edhe organet e UEFA-së janë të njoftuara për procesin gjyqësor që do ta kemi. FC Prishtina do ta informoj opinionin në kohë reale për çdo vendim që do të merret", thuhet në reagimin e FC Prishtina.

## Shqipëria me 10 sportistë në Lojërat Olimpike Speciale në Berlin



TIRANË, 15 QERSHOR - Berlini është gati për t'i pritur Lojërat Olimpike Speciale, të cilat do të nisin në kryeqytetin gjerman mbrëmjen e 17 qershorit me ceremoninë hapëse dhe do të dhurojnë emocione për plot 9 ditë me radhë. Në këtë edicion të Lojërave Olimpike Speciale do të marrin pjesë rreth 7 000 atletë si pjesë e delegacioneve nga 190 vende të botës, mes të cilave edhe Shqipëria dhe do të garojnë në 26 sporte olimpike të ndryshme. Vendi ynë do të përfaqësohet me 10 sportistë, të cilët do të garojnë në sporte si peshëngritja, noti, basketbolli e atletika, teksa delegacioni kuqezi ka mbërritur tashmë në kryeqytetin gjerman dhe është gati të bëhet pjesë e ngjarjes speciale më të madhe në botë. Lojërat Olimpike Speciale Botërore kanë nisur të organizohen që prej 1968-s dhe mbahen në mënyrë periodike çdo katër vjet, teksa pjesëmarrës janë atletë me aftësi të kufizuara intelektuale. Synimi i këtyre lojërave është t'u mësojë atletëve aftësi si disiplina dhe puna ekipore, të cilat janë drejtpërdrejt të transferueshme në shkolla, vendet e punës dhe komunitetet. Ky event synon të tregojë edhe njëherë se sporti nuk është vetëm një garë me një fitues, por shumë më tepër se kaq, një ndikues i madh në jetesën në shoqëri, për të gjithë njerëzit, pa dallim moshe, gjinie, aftësie apo ngjyre.

## Daliq: Fitore historike, ka ardhur koha ta fitojmë medaljen e artë



Zagreb, 15 qershor - Kroacia mposhti Holandën në gjysmëfinalen e "Final Four" në Ligën e Kombeve dhe u kualifikua në finale. Kombëtarja ballkanike triumfoi 4-2 përballë Holandës në "De Kuip" të Roterdamit. Trajneri Zlatko Daliq ka një dedikim të veçantë për triumfin kundër "tulipanëve". "Këtë fitore ia dedikojmë popullit kroat. Tifozët u treguan sërish fantastikë me mbështetjen e pakursyer ndaj nesh. Kjo ishte një ndër fitoret më të mëdha. Një sukses historik! Të thyesh 4-2 Holandën në fushën e saj është diçka që do të mbetet në histori. Ne punojmë fort në stërvitje dhe tani po shijojmë frytet e sakrificave tona. Lojtarët e konfirmuan edhe njëherë se janë gati të luftojnë kur vjen puna për Kroacinë. Fituam një tjetër medalje pas asaj në Kupën e Botës, por tani duam medaljen e artë. Pas medaljes së argjendtë dhe të bronztë, tani ka ardhur koha ta fitojmë medaljen e artë", ka thënë Daliq.

# Bellinghami merr fanellën me numrin 5: Reali, klubi më i madh në histori




MADRID, 15 QERSHOR - Jude Bellingham është prezantuar edhe zyrtarisht te Real Madridi në konference për shtyp, të cilën e ka mbajtur së bashku me presidentin e klubit, Florentino Perez. Ylli anglez u largua nga Borussia Dortmundi për ta provuar një përvojë të re, ndërsa është i gatshëm për sfidat që e presin në "Santiago Bernabeu". Ai ndihet i lumtur që po e realizon një ëndërr, ndërsa premton se do ta japë maksimumin për të arritur suksese me madrilenët. "Është një kënaqësi të jem këtu. Është klubi më i madh në histori, jo shumë lojtarë e kanë mundësinë të luajnë këtu. Jam mjaft mirënjohës për ata që më kanë sjell të luaj në këtë skuadër. Në Angli gjithmonë kam bërë tifo për Realin, nuk mund ta refuzoja këtë mundësi. Do të ishte më e lehtë po të kthehesha në Angli, por doja të dilja nga 'zona komode'. Është moment i duhur, jam aty ku doja të isha", ka thënë Bellingham, i cili ka zbuluar se edhe kishte biseduar me Borussia Dortmundin për ofertën e Realit dhe se dëshironte t'i bashkohet kësaj skuadre sa më shpejt.

Talenti anglez ka zbuluar edhe pse e mori fanellën me numrin 5, të cilin e kishte bartur legjenda Zinedine Zidane. "E falënderoj Vallejon, kemi biseduar dhe nuk i jam imponuar. I jam mjaft mirënjohës. E admiroj shumë Zidanen, ka lënë pasardhës të mëdhenj në këtë klub. Unë jam ndryshe, por është një numër që më inspiron. Fanella e Realit është një përgjegjësi e madhe dhe, ndoshta, kjo zgjedhje mund të më vë në një pozitë jokomode. Gjithmonë e kam vlerësuar shumë Zidanen. Për mua ka qenë më i miri. Shpresojmë që mund ta ndjek rrugën e tij. Është një nder", ka deklaruar Bellingham, i cili e vlerëson Carlo Ancelottin si njërin prej më të mirëve në histori.

Ish-anëtari i Dortmundit ka thënë se do të jetë një përvojë e madhe të luaj së bashku me mesfushorët Modriq - Kroos. "Për mua do të jetë një përvojë e vlerës së lartë. Mënyra se si luajnë, vizioni i tyre i lojës, përvoja… Do t'i ndjek shumë në javët e para. Dua të mësoj nga ta. E kemi një skuadër të jashtëzakonshme dhe mezi pres të jem një prej tyre", ka pohuar Bellinghami.

# Wolff: Mercedesi po rikthehet, rinovimi me Hamiltonin çështje ditësh



SHTUTTGART, 15 QERSHOR - Ngjitja e të dy pilotëve të saj në podium në garën e fundit në Spanjë ka rikthyer entuziazmin te skuadra e Mercedesit, që synon t'i afrohet sa më shumë Red Bullit. Në prag të garës së Formulës 1 që zhvillohet këtë fundjavë në Kanada, shefi i makinës gjermane, Toto Wolff, zbulon risitë e fundit për sa i përket makinës dhe jo vetëm. Ai sqaron se rinovimi i kontratës me Lewis Hamiltonin është pranë finalizimit: "Mendoj se tashmë është çështje ditësh që ta zyrtarizojmë rinovimin e kontratës me Lewisin. Kemi një marrëdhënie shumë të mirë dhe shumë shpejt do ta japim lajmin. Lewisi dhe Mercedesi njihen prej vitesh, ndaj është një lidhje normale". "Unë dhe Lewisi kemi ardhur së bashku te Mercedesi në vitin 2013 dhe në këto 10 vjet, nga një marrëdhënie profesionale, kemi shkuar në miqësi. Për mua është personaliteti më i madh i këtij sporti, ndaj meriton çdo kërkesë që ka ndaj nesh", ka thënë Toto Wolff. Ai premton se makina do të jetë mjaft e mirë në garën e radhës në Kanada: "Kemi bërë disa hapa përpara nga ana e inxhinierisë, pas vendimeve teknike që morëm. Ndaj mendoj se po rikthehemi protagonistë. Para 10 ditësh arritëm një rezultat të mirë, ndaj është thjesht çështje kohe, nuk kam asnjë dyshim".

## SHKURT

### Interi menjëherë refuzon ofertën e Newcastelit për Barellan

Nicolo Barella ka qenë një nga mesfushorët më të mirë në Itali dhe protagonist me fanellën e Interit. Mesfushori italian ka bërë sezone shumë të mira, gjë e cila e ka futur në radarët e shumë klubeve në Evropë. Të mërkurën është raportuar se një ofertë me vlerën e 60 milionë eurove ka mbërritur tek Interi për shërbimet e mesfushorit. Newcastel United po synon të këtë një ekip dinjitoz në Ligën e Kampionëve dhe ka nisur nga merkatoja. Megjithatë, përgjigjja e zikaltërve ka qenë e menjëhershme, duke refuzuar ofertën për mesfushorin që konsiderohet i paprekshëm nga Interi.

### Wimbledoni, premi e jashtëzakonshme për fituesit dhe pjesëmarrësit

Me datat 3-16 korrik, në Londër, do të zhvillohet grand slami i tretë sezonal, ai i Wimbledonit, që është edhe turneu më i rëndësishëm i fushave me bar. Organizatorët e këtij turneu bënë me dije se të ardhurat për pjesëmarrësit në këtë turne kanë njohur një rritje rekord, duke bërë që edhe premitë të jenë rekord. Kështu, në total, për të gjithë tenistët pjesëmarrës do të jepen 44.7 milionë stërlina, një rritje me 11.2 % më shumë se vitin e kaluar. Turneu më antik i tenisit në botë tregon edhe një herë se pavarësisht prej problemeve të vitit të kaluar (nuk lejoi tenistët rusë e bjellorusë) është i paarritshëm nga të tjerët. Tenistët fitues do të arkëtojnë nga 2.35 milionë stërlina, ndërsa finalistët nga 1.175 milion stërlina. Gjysmëfinalistët do të arkëtojnë nga 600 mijë stërlina, ndërsa ata që eliminohen në çerekfinale do të paguhen 340 mijë stërlina. Edhe raundi i parë ka një rritje të konsiderueshme të të ardhurave, me 55 mijë stërlina premi.

### Mourinho refuzon ofertën e klubit nga Arabia

Trajneri Jose Mourinho në Londër është takuar me drejtuesit e klubit të Al Ahlit në krye me ish presidentin Valid Moaz. Presidenti i klubit arab i ka ofruar Mourinhos një kontratë dyvjeçare dhe miliona euro përfitime, ndërkohë që shuma mendohet të jetë rreth 100 milionë euro për dy sezone. Megjithatë, trajneri portugez e ka refuzuar ofertën faraonike nga Arabia Saudite. Ai ia ka bërë të qartë presidentit se nuk është i interesuar të largohet nga Roma dhe se ka një objektiv dhe një projekt me verdhekuqtë. Mourinho mund të largohet nga Roma vetëm në rast se ka një ofertë nga Real Madridi ose PSG-ja, në raste të tjera "Gazzetta dello Sport" raporton se largimi është i pamundur.

### Unitedi heq dorë nga Kane

Manchester Unitedi është tërhequr nga gara për Harry Kane, duke qenë se e konsideron shumë të lartë çmimin që i ka vënë Tottenham Hotspuri. "The Guardian" njofton se "Djajtë e Kuq" nuk mund ta paguajnë shumën e kërkuar nga "Spurs"-at për nënshkrimin e sulmuesit anglez. Kane ka vetëm një vit në kontratën e mbetur, ndërsa pronari i klubit, Daniel Levy, nuk shumë i interesuar ta shesë në këtë afat kalimtar. Në rast të mostransferimit dhe mosrinovimit të kontratës, atëherë 29-vjeçari mund të largohet në verën e ardhshme me parametrat zero. Derisa Unitedi e ka kthyer interesimin kah sulmuesi i Atalantas, Rasmus Hojlund. Për kapitenin e Tottenhamit është i interesuar edhe Real Madridi.

## Reali nuk shpenzon 200 milionë euro për Mbappen, kërkon Martinezin dhe Hakimin

Duke parë vështirësitë financiare për ta blerë sulmuesin francez Kylian Mbappe, skuadra e Real Madridit ka ndryshuar objektiva për sa i përket sulmit. Madrilenët janë vënë në ndjekje të pasuesit të Karim Benzemas dhe, sipas "Mundo Deportivo", i pari në listë është argjentinasi Lautaro Martinez që luan me Interin. 25-vjeçari kampion bote ka një kontratë deri në vitin 2026 me zikaltrit dhe kushton rreth 80 milionë euro, një shumë më e ulët se 200 milionët që kërkon PSG-ja për Mbappen. Mësohet se trajneri Carlo Ancelotti ia ka bërë të qartë klubit se Lautaro Martinez është i përshtatshëm për lojën e tij. Bashkë me argjentinasin, kërkesa e dytë është 25-vjeçari maroken Achraf Hakimi. Ky i fundit ka kontratë deri në vitin 2026 me parisienët dhe kushton rreth 70 milionë euro.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "G&S Trade" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811345611 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "G&S Trade" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811345611 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "G&S Trade" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811345611 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BASILICO PIZZA" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811869322 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "BASILICO PIZZA" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811869322 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "BASILICO PIZZA" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811869322 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besmir Ibrahimi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. II, III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Rexh Maliqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 dhe Diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Sahide Sallahi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu " Migjeni " Gjinoc .

- Halil Sokolaj shpall te pavlefshme dëftesat e kp I - VII shfmu " Bajram Curi " Romaje.

- Emel Takijaci shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren .

- Hamez Memcaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Erkan Gashi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Bekim Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit" Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,
info@kolegjibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **26.05.2023**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

# KONKURSI PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK 19.06.2023 deri më 12.07.2023

## I.PROFESOR

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin | **MENAXHMENT DHE EKONOMIKS - BA** |
| 2. | Dy (3) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin | **JURIDIK LLB** |
| 3. | Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin | **MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - BA** |
| 4. | Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin | **BANKA DHE FINANCA NË BIZNES - BA** |
| 5. | Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin | **MENAXHMENT DHE FINANCA - MA** |

## II.ASISTENT

1. Një (1) asistent për lëndë ekonomike,
2. Një (1) asistent për lëndë juridike,
3. Një (1) asistent për lëndë të emergjencave,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi.**
**Për vendin e punës mësimdhënës**, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.
**Për vendin e punës asistent**, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar studimet Master në lëmin përkatëse, preferohet të kenë të regjistruar studimet e doktoratës (PhD).
Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.
Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Diplomat origjinale Ose kopjet e diplomave (baçelor, master, magiistraturë dhe doktoratë) të vërtetuara nga noteri; Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.
Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet Master jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.
Konkursi mbetet i hapur nga **19.06.2023 deri më 12.07.2023.**
Paraqitja e dokumenteve: Rr.Motrat Qiriazi 29, 10000 Prishtinë, Kosovë dhe përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com
Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.
Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com
Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

Përparimi
Vushtri

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A - VUSHTRI
Nr. Protokollit: 722/23
Data: 14.06.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, lidhur me pozitat e punës të cilat janë paraparë me nenin 16 nën pikën 1.7.3 dhe 1.8.3 të Rregullores Nr. 35/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A e miratuar me datë 06.05.2023 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr.721/23 të datës 14.06.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 14.06.2023 shpall:

## KONKURS PUBLIK

**I. Titulli:** Sigurim Fizik - roje
**Numri i ekzekutuesve:** 1
**Orët e punës:** 40 orë në javë
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
**Përgatitja profesionale:** Shkolla e Mesme apo fillore
**Përvoja e punës:** Preferohet gjashtë (6) muaj
**I raporton:** Udhëheqësit të Njësisë së Sigurimit Fizik
**Koeficienti i pagës:** 3.9

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:**

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa ndalim të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën qe e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të udhëzimeve nga menaxhmenti i ndërmarrjes;.

**Kushtet e veçanta**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet te jete origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

**II. Titulli:** Pastrues i Zyrave dhe Objekteve
**Numri i ekzekutuesve:** 1
**Orët e punës:** 40 orë në javë
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
**Përgatitja profesionale:** Shkolla fillore
**Përvoja e punës:** Nuk kërkohet përvojë pune
**I raporton:** Udhëheqësit të Njësisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
**Koeficienti i pagës:** 3.9

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:**

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjesitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të udhëzimeve nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë së Mirëmbajtjes-Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve.

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet te jete origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk janë të obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

**Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.**

Kandidatët e interesuar, formularët për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82 (ish objekti i Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Konkursi është i hapur nga data 15.06.2023 deri me datë 29.06.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 15[illegible]

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta [illegible]






NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
Përparimi
Vushtrri

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A. - VUSHTRRI
Nr. Protokollit: 722/23
Data: 14.06.23

Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, u vezi sa radnim mestima koja su predviđena članom 16 pododjeljkom 1.7.3 i 1.8.3 Pravilnika br. 35/23 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u N.P.L. "Përparimi" Sh.A, odobrenom dana 06.05.2023. od strane Stručnog odbora N.P.L "Përparimi" Sh.A, i na osnovu odluke br. 721/23 od godine 14.06.2023 izvršnog direktora, N.P.L "Përparimi" Sh.A, dana 14.06.2023. objavljuje:

## JAVNI KONKURS

**I. Naslov:** Fizičko obezbeđenje
**Broj izvršilaca:** 1
**Radno vreme:** 40 sati nedeljno
**Trajanje imenovanja:** Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja
**Stručna priprema:** Srednja škola i Osnovna škola.
**Radno iskustvo:** Najmanje šest (6) meseci
**Izvještava:** Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;
**Koeficijent plate:** 3.9

**Opis radnih obaveza i odgovornosti:**

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristitisva predviđena sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, možetetakođe je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

**Posebni uslovi:**

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbedenja Favorite;
- Prednost se daje osobama sa licencom u oblasti fizičke sigurnosti.

**Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:**

- Obrazac prijave za NPL "Perparimi" Sh. A .;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uverenje o krivičnoj prošlosti koje ne sme biti starije od šest (6) meseci.
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i da se donosi u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci);.

**II. Naslov:** Cistač kancelarija i objekata
**Broj izvršilaca:** 1
**Radno vreme:** 40 sati nedeljno
**Trajanje imenovanja:** Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja
**Stručna priprema:** Osnovna škola
**Radno iskustvo:** Nije potrebno radno iskustvo
**Izvještava:** Rukovodioci jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata
**Koeficijent plate:** 3.9.

**Opis radnih obaveza i odgovornosti:**

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upucen od pretpostavljenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i druge obaveze vezane za radno mesto a na osnovu zahteva pretpostavljenog
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

**Uz prijavu se mora priložiti sledeće:**

- Obrazac prijave za N.P.L „Përparimi" Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci):.
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji, nije obavezan);
- Kopija lične karte

**Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.**

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Peparimi" Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 15.06.2023 do 29.06.2023 u 16:00 časova.

N.P.L "Peparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 175.

Napomena: [illegible] navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune [illegible]




ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues